



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

---

## **Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit**

Programi i studimit:  
**Programi Pedagogji e Përgjithshme**

*Niveli i studimeve:*  
Bachelor

*Numri i kredive:*  
180 ECTS

*Akredituar për periudhën:*  
1 Tetor 2021 - 30 Shtator 2024

## PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	3
2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT .....	4
3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Pedagogji e Përgjithshme .....	5
4. PËRSHKRIMET E KURSEVE .....	7

## 1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit të Pedagogjisë së Përgjithshme është të përgatisë kandidatë të cilët do të jenë në gjendje të analizojnë, vlerësojnë dhe reflektojnë në mënyrë kritike mbi problemet aktuale pedagogjike dhe që do të zbatojnë në mënyrë cilësore teoritë dhe praktikën bashkëkohore si bashkëpunëtorë profesionistë në institucionet pedagogjike, sociale dhe kulturore. Studimet Bachelor të Pedagogjisë synojnë arsimin bazë pedagogjik me fokus në lëndët që trajtojnë aspekte teorike dhe praktike në sferat pedagogjike, sociale dhe kulturore.

Misioni i Programit të Përgjithshëm të Pedagogjisë është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit. Misioni i programit është të sigurojë një program cilësor për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve dhe specialistëve të tjerë në fushën e arsimit për avancimin e sistemit arsimor në Kosovë.

## 2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT

Në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

- Hartojne projekte në sferën pedagogjike, sociale dhe kulturore
- Hartojne plane për zhvillimin individual të nxwnësve me nevoja të veçanta;
- Asistojnë dhe mbështesin mësuesit në menaxhimin e klasës;
- Promovojë komunikimin shkollë-familje-komunitet dhe zbatojnë mënyra të ndryshme për partneritetin me familjen dhe komunitetin;
- Promovojne vlerësimin bashkëkohor të performancës së nxwnwsve në arritjen e kompetencave të parashikuara sipas niveleve të arsimit;
- Kontribuojne në organizimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional në nivel shkolle, duke sensibilizuar të tjerët për mësimin gjatë gjithë jetës;
- Analizojnë në praktikë shembuj të komunikimit profesional dhe avancojnw kulturën komunikuese në nivelin e institucionit.
- Sigurojne mundësi për qasje gjithëpërfshirëse në procesin e zbatimit të planit dhe programit, duke i dhënë mundësi të barabarta secilit;
- Reflektojnë dhe planifikojneë për zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës me fëmijë dhe kolegwn mwsimdhwnws.
- Promovojne vlerat, besimet, qëndrimet mbi të cilat zhvillohet identiteti shoqëror dhe kombëtar bazuar në vlerat demokratike për arsimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në vend.

### 3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Pedagogji e Përgjithshme

VITI I					
SEMESTRI I					
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	HYRJE NË PEDAGOGJI	3	2	7
2	O	HISTORI E PEDAGOGJISË BOTËRORE	2	1	5
3	O	PSIKOLOGJI E PËRGJITHSHME	2	2	6
4	O	EDUKIMI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE	2	2	6
5	O	GJUHË ANGLEZE	2	2	6
			11	9	30
SEMESTRI II					
1	O	PEDAGOGJI SHKOLLORE ME PUNË PRAKTIKE	3	2	7
2	O	SHKATHTËSITË E STUDIMIT AKADEMIK	2	2	6
3	O	HISTORI E PEDAGOGJISË KOMBËTARE	2	1	6
4	O	PEDAGOGJI FAMILJARE	2	2	6
5	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM	2	1	5
6	Z	PRAKTIKUM I GJUHËS SHQIPE	2	1	5
7	Z	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	2	1	5
			11	8	30
<b>*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).</b>					
VITI II					
SEMESTRI III					
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME	2	2	6
2	O	BAZAT E DIDAKTIKËS	3	2	7
3	O	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2	2	6
4	O	PUNA NË KOMUNITET	2	2	6
5	Z	SHKENCAT SHOQËRORE DHE KURRIKULA	2	1	5
6	Z	KURRIKULA E MATEMATIKËS DHE MENTORIMI	2	1	5
7	Z	ARSIMIMI GJATË GJITHË JETËS	2	1	5
			11	9	30
<b>*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).</b>					
SEMESTRI IV					
1	O	PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI NË ARSIM	3	2	7
2	O	PSIKOLOGJI ZHVILLIMORE	2	2	6

3	O	STATISTIKË	2	2	6
4	O	MENAXHIMI I KLASËS	2	2	6
4	Z	ORIENTIMI NË KARRIERË	2	1	5
6	Z	ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	2	1	5
7	Z	SHKENCAT NATYRORE DHE KURRIKULA	2	1	5
			11	9	30

**\*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).**

### VITI III

#### SEMESTRI V

Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	3	1	6
2	O	ARSIMIMI I TË RRITURVE	2	2	6
3	O	PRAKTIKUM I PUNËS SË PEDAGOGUT	3	1	6
4	O	PSIKOLOGJI E EDUKIMIT	3	2	7
5	Z	ETIKA NË MËSIMDHËNIE	2	1	5
6	Z	BAZAT TEKNOLOGJIKE TË PUNËS MËSIMORE	2	1	5
7	Z	ARTET DHE KURRIKULA	2	1	5
			13	7	30

**\*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).**

#### SEMESTRI VI

1	O	PEDAGOGJI SPECIALE	3	1	6
2	O	METODIKË ME PUNË PRAKTIKE	3	2	7
3	O	PRAKTIKË NË IA	2	2	6
		SISTEMI I ARSIMIT NË KOSOVË	2	2	6
4	Z	EDUKIMI FIZIK DHE SHENDËTESOR	2	1	5
6	Z	MENAXHIMI I PROJEKTEVE	2	1	5
7	Z	SHKATHËSITË PËR JETË DHE PUNË	2	1	5
8	O	PROVIM DIPLOME (PORTFOLIO)			5
			12	8	30

**\*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).**

## 4. PËRSHKRIMET E KURSEVE

### Përshkrimi për secilin kurs

#### **HYRJE NË PEDAGOGJI**

Në këtë kurs do të ofrohen përmbajtje bazike në lidhje me pedagogjinë si shkencë duke filluar nga objekti i studimit të saj, edukata, qëllimet e edukatës dhe për zanafillën dhe karakteristikat e saj si dhe për rëndësinë që ka për formimin e individit dhe të shoqërisë. Studentët do të analizojnë dhe kuptojnë nocionet themelore pedagogjike si: arsimit, të nxënës, mësimdhënia, mësuesi, klasa, ora mësimore, etj. Më pas studentët do të njihen me fushat e edukatës, fazat nëpër të cilat kalon edukimi i individit, format e edukimit, etj. Një analizë kritike e sistemeve të ndryshme të edukimit nëpër botë do të jetë pjesë e këtij kursi, gjithashtu.

#### **HISTORI E PEDAGOGJISË BOTËRORE**

Kjo lëndë ngërthen trajektoren e zhvillimit historik të arsimit dhe të mendimit pedagogjik në shkallë botërore. Historia e pedagogjisë botërore, trajton lindjen dhe zhvillimin e edukatës, arsimit dhe mendimit pedagogjik në të kaluarën e shoqërisë njerëzore, duke filluar prej të kaluarës më të largët deri te e kaluara e afërt e saj. Kursi përqendrohet sidomos, në ngjarje, ndryshime, institucione dhe personalitete të veçanta dhe kontributi i tyre në këtë fushë. Kursi përpiket t'i vë në fokus zhvillimet në fushën e edukatës duke filluar nga edukata në bashkësinë e parë "primitive", në shoqërinë skllavopronare, në shoqërinë feudale, pedagogjia dhe arsimit në shoqërinë qytetare shek. XVII-XVIII, pedagogjia e shek XIX dhe arsimit deri në ditët tona. Studentët mësojnë për institucionet e ndryshme edukative dhe personalitete më të rëndësishme të historisë së arsimit dhe mendimit pedagogjik botëror, idetë dhe mendimet pedagogjike të tyre në të kaluarën dhe rëndësia aktuale e tyre dhe teoritë bashkëkohore të edukatës.

#### **HYRJE NË PSIKOLOGJI**

Kursi është i dizajnuar në mënyrë që të njoftojë studentët me konceptet dhe teoritë kryesore që e përkufizojnë psikologjinë si shkencë të studimit të mendjes dhe sjelljes, dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme. Kursi shtjellon teoritë themelore psikologjike dhe metodat e studimit të saj, njohuritë e proceseve bazike kognitive, emocionale dhe biheviorale sipas gjurmimeve empirike, dhe analizën e llojllojshmërisë së faktorëve që ndikojnë ndijimet, perceptimet, të mësuarit, kujtesën, motivimin, ndjenjat dhe shëndetin. Kursi bën diferencimet në mes të informatave shkencore dhe jo-shkencore rreth sjelljes njerëzore dhe proceseve mendore, dhe përshkruan proceset psikologjike që ndërveprojnë tek fëmija. Njohuritë nga kursi u ofrojnë studentëve një perspektivë të plotë mbi botën, njohjen e vetes dhe të tjerëve dhe të kuptuarit e kompleksitetit të sjelljes njerëzore, dhe do të fokusohet në ngritjen e shkathtësive të studentëve për të zbatuar konceptet dhe parimet psikologjike në situata të punës dhe jetës së përditshme.

#### **EDUKIMI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE**

Kjo lëndë trajton parimet udhërrëfyese të të drejtave njerëzore të fëmijës, si mbijetesën dhe zhvillimin, mbrojtjen dhe mosdiskriminimin, pjesëmarrjen dhe interesat më të mira për fëmijën. Aspirata për të mbrojtur identitetin dhe dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore, pa

përbashkëta universale të mbrojtura përmes standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, e njohur si Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

### **GJUHË ANGLEZE**

Gjuhë angleze është kurs semestral i cili i ekspozon studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, të cilat kanë të bëjnë me tema të ndryshme nga përditshmëria nëpërmjet të cilave studentët do të jenë në gjendje të shprehin shkathtësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht t'i përmirësojnë katër shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, në funksion të rrjedhshmërisë dhe saktësisë. Temat e mbuluara gjatë kursit do të përfshijnë një llojllojshmëri të ushtrimeve gramatikore dhe të leksikut të cilat do t'u ndihmojnë studentëve të arrijnë një zotërim të kënaqshëm të gjuhës angleze, duke pasur gjithmonë në fokus gërshetimin e kompetencës dhe performansës gjuhësore, si imperativ për zotërimin e një gjuhe të huaj.

### **PEDAGOGJI SHKOLLORE ME PUNË PRAKTIKE**

Në këtë kurs ofrohen njohuritë bazike nga fusha e pedagogjisë shkollore, duke filluar me zotërimin e koncepteve bazë nga fusha e pedagogjisë shkollore, si: shkolla, mësimi, arsimit, edukata. Më pas do qartësohen diferencat mes shkollës tradicionale dhe bashkëkohore. Kursi ofron mundësinë e njohjes së zhvillimit historik të shkollës, teoritë më të rëndësishme mbi shkollën, deri tek organizimi i sotëm bashkëkohorë i saj, duke u *aftësuar kë shtu për reflektim në mënyrë kritike për organizimin e shkollës me të rë kompleksitetin e saj*. Studentët më pas do njihen edhe me mënyrën e udhëheqjes dhe mbikqyrjes së shkollës, në fokus të vecantë me përcjelljen dhe mbikqyrjen e saj nga pedagogu i shkollës. Lënda trajton parimet udhërrëfyese të përparimit të shkollës. Kursi përfshinë dhe punën praktike të studentëve e cila është e paraparë në kohëzgjatje një muaj, gjatë së cilës studentët do bëjnë ndërlidhjen e informacioneve të marra nga kursi dhe reflektimin e tyre në praktikë .

### **SHKATHTËSITË E STUDIMIT AKADEMIK**

Kursi *Shkathtësitë e studimit akademik* është planifikuar për studentët me qëllim që të fitojnë qëndrimet dhe aftësitë e nevojshme për të qenë nxënës efektivë gjatë gjithë jetës, për të rritur aftësitë e të mësuarit, për sukses në mësim dhe të mësuar gjatë gjithë jetës. Në kurs do të trajtohen strategjitë për mësimnxënie të suksesshme, mjetet që ndihmojnë kujtesën, teknika të të mësuarit, shprehitë e mira të studimit, teknikat e të lexuarit për të kuptuarit e saktë të tekstit, strategjitë për të dëgjuarit aktiv dhe mbajtjen e shënimeve, strategjitë për hulumtim dhe evidentim të burimeve, strategjitë për planifikimin dhe menaxhimin efektiv të kohës, strategjitë për menaxhim të ankthit dhe stresit para provimit.

### **HISTORI E PEDAGOGJISË KOMBËTARE**

Kursi shtjellon trajektoren e zhvillimit historik të arsimit dhe të mendimit pedagogjik nga lashtësia deri në të kaluarën e afërt të popullit shqiptar. Historia e pedagogjisë kombëtare është dizajnuar që t'i përfshijë edhe të gjitha ngjarjet historike në fushën e arsimit, ngërthen zhvillimet shoqërore, përpjekjet për shkollë dhe arsimin shqip, ndikimet e shkollave të huaja në trevat shqiptare dhe jashtë tyre në të cilat u arsimuan shumë shqiptarë, zanafilla dhe



zhvillimi i institucioneve të para kombëtare edukativo arsimore dhe personalitetet e veçanta kombëtare që lanë gjurmë në historinë e arsimit kombëtar e disa prej tyre edhe në kulturën dhe civilizimin evropian.

Programi i këtij kursi fokusohet në një rrjedhë kronologjike duke filluar nga ilirët, mesjeta, humanistët, arsimi dhe mendimi pedagogjik shqiptar në shek. XVI-XVII, arsimi dhe mendimi pedagogjik në shek. XVIII deri në vitet '30 të shek XIX , arsimi dhe mendimi pedagogjik shqiptar nga vitet '30 të shek. XIX deri në vitin 1912, duke arritur deri te historiku i arsimit të lartë shqiptar.

### **PEDAGOGJI FAMILJARE**

Kursi ndërthen njohuri bazike nga pedagogjia familjare, tipologjitë e familjeve, ligjësitë dhe proceset e edukimit familjar; përmbajtje përkitazi me faktorët primarë edukativë në familje, karakteristikat e edukimit në moshë të ndryshme, rrethanat specifike të edukimit të fëmijëve, njohuri për procesin e partneritetit edukativ brenda familjes dhe në mikromjedise tjera socio-edukative. Studentët do të përgatiten për këshillim për jetë në familje për të rinjë dhe të interesuar të tjerë duke përfshirë, crregullime në sjellje të fëmijëve të moshave të ndryshme, crregullime në sjellje të prindërve, situatat abuzive në familje dhe raportimin e tyre etj.

### **EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM**

Nevoja për zhvillim të qëndrueshëm është ndër sfidat e shoqërisë njerëzore sot përfshirë shoqërinë kosovare. Kursi ofron njohuri teorike për zhvillimin e qëndrueshëm si koncept zhvillimor global dhe shkathtësi praktike për zhvillimin e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Kursi do zhvilloj kompetencat për të zbatuar strategji bashkëkohore të të nxëniet për qëndrueshmëri si: qasja holistike, të menduarit sistemik dhe kritik, të nxëniet me hulumtim, mësimdhënia e integruar, pjesmarrjen në vendimmarrje si qytetar aktiv dhe të përgjegjshëm.

### **PRAKTIKUM I GJUHËS SHQIPE**

Ky kurs u ofron studentëve njohuri të avancuara për gjuhën e sotme shqipe, për fonetikën dhe morfosintaksën e saj, duke vënë në qendër të vëmendjes vështirësitë e zbatimit të standardit jo vetëm në shkollë, por edhe në shoqëri (institucione, veprimtari botuese, medie etj). Po ashtu, kursi do t'u mundësojë studentëve t'i thellojnë njohuritë e tyre për parimet dhe rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde, si dhe zbatimin e tyre në praktikë (aplikimi).

### **GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**

Kursi do trajtojë çështje si komunikimin gjuhësor i cili është lloji kryesor i komunikimit midis njerëzve. Në këtë lloj komunikimi përdoren të gjitha llojet e ligjërimeve (të folur dhe të shkruar). Komunikimi është i lidhur ngushtë me zhvillimin e shoqërisë. Ai është një proces i pafund, sepse njerëzit kanë nevojë të komunikojnë vazhdimisht. Në *procesin e të mësuarit* komunikimi kuptohet si mesazh dhënieje dhe marrjeje informacioni. Mësuesi jep mesazhin dhe nxënësi e merr atë. Në pjesën e dytë të kursit, përqendrimi është në mënyrat e zbatimit të kompetencave sipas Kornizës së Kurrikulit të Kosovës me përqendrim të vecantë në fushën: Gjuhët dhe komunikimi përmes të cilave realizohet një nga kompetencat kryesore: komunikues i suksesshëm.

### **PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME I**

Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të njohur/kuptuar dhe përkrahur edukimin e fëmijëve në aspektin fizik dhe shëndetësor, motorik, mendor, emocional, social e moral, pastaj zhvillimin e shakthtësive për jetë dhe punë dhe kreativitetin tek secili individ, që nga lindja dhe deri në moshën madhore. Do të flitet për parimet, metodat, mjetet dhe format më të përshtatshme për përkrahjen e zhvillimit në të gjitha fushat e përmendura më lartë. Duke qenë se njeriu mëson ë zhvillohet gjatë gjithë jetës, qëllimi i kursit është vetëdijësimi për investim të vazhdueshëm në të gjitha fushat e zhvillimit dhe të personalitetit të njeriut.

### **BAZAT E DIDAKTIKES I**

Ky kurs është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë – të nxëniet dhe pjesa e dytë – mësimdhënia. Kursi ofrohet për të promovuar filozofinë dhe strategjinë bashkëkohore të të nxëniet dhe mësimdhënies. Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi themelore përkitazi me të nxëniet, teoritë e të nxëniet, stilet e të nxëniet, konceptet rreth mësimdhënies, strategjive ndërvepruese të mësimdhënies, format e punës mësimore, planifikimi i punës mësimore, vlerësimi, etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teoritë e të nxëniet dhe të mësimdhënies dhe të zbatojnë strategji ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat promovojnë të menduarit kritik dhe kreativ. Gjithashtu, studentët do të analizojnë plane të punës mësimore mbi bazën bashkëkohore të mësimdhënies dhe analizës së bërë në praktikën pedagogjike të shkollës kosovare.

### **BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM**

Ky kurs ofron njohuritë bazike nga fusha e metodologjisë pedagogjike, nga njohja e teorive, paradigmave dhe këndvështrimeve, e deri te lidhja e këtyre elementeve me botën e vërtetë të praktikës së hulumtimit. Studentët do të njihen me fazat e hulumtimit shkencorë me të gjitha karakteristikat dhe rëndësinë e zbatimit të tyre. Në fokus të veçantë do të jetë aftësimi për planifikim të projektit të hulumtimit me tërë elementet e tija, duke u përqendruar në çështjen e formulimit të pyetjeve hulumtuese, si dhe përkufizimet e qarta operative me qëllim që puna jonë si hulumtues të jetë e kuptueshme dhe e vlefshme. Vijohet më pas me variablat, hipotezat dhe dizajnet e studimit. Ky proces studimor bëhet më domethënës me njohjen e metodave të kampionimit nga studentët t, që është e domosdoshme të përvetësohet mirë nga studentët në mënyrë që hulumtimi të arrijë vlerën shkencore.

### **PUNA NË KOMUNITET**

Kursi është multi-disciplinar dhe ngritet mbi rëndësinë e aftësimin të studentëve për të zbatuar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në punën me fëmijët/adoleshentët në komunitet, përfshirë OJQ-të, qendrat komunitare, shërbimet komunitare për grupet e marginalizuara. Kursi përgatit studentët për të punuar me fëmijët që vijnë nga kontekstet e ndryshme sociale dhe jetësore- fëmijët që jetojnë në varfëri, fëmijët- në konflikt me ligjin, fëmijët abuzues substancash psiko-aktive, fëmijët pa kujdes prindëror, etj. Identifikimi i hershëm dhe intervenimi mbrojnë fëmijët nga situatat e rrezikshme të cilave mund ti ekspozohen si rezultat i keqtrajtimit. Kursi shtjellon edhe instrumentet ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Më tej, kursi aftëson studentët për të identifikuar shenjat dhe simptomat e keqtrajtimit apo ekspozimit ndaj dhunës dhe keqtrajtimit, efektet që kanë këto në zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës, metodat e punës me fëmijët që nuk kanë fatin të kenë një fëmijëri të

lumtur, si dhe i përgatit ata për ballafaqimin me situata të keqtrajtimit në punën e tyre direkte me fëmijët.

### **SHKENCAT SHOQËRORE DHE KURRIKULA**

Shkencat shoqërore dhe kurrikula prezantojnë: studimin e botës njerëzore dhe kulturave e vlerave kulturore e materiale në drejtim të progresit të civilizimit. Po ashtu, kursi ofron njohuri pedagogjike dhe shkathtësi praktike për studentët në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e kurrikulës në Fushën kurrikulare Shkencat shoqërore. Ofrohen përmbajtje bazike për kulturën shkencore tek shkencat shoqërore, të kuptuarit e parimeve themelore të njohjes teorike dhe empirike, njohja e punës teorike, reporti i punës teorike dhe asaj hulumtuese në drejtim të problematikës së avancimit të çështjeve epistemologjike. Kursi ofron kompleksin e njohjeve, dijeve filozofike-njohja e koncepteve elementare sociologjike, antropologjike, historike, pedagogjike, psikologjike, politike, ekonomike, kulturore, komunikologjike etj.

### **KURRIKULA E MATEMATIKES DHE MENTORIMI**

Kursi është planifikuar të zhvillojë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme për këshillim pedagogjik në fushën kurrikulare/lëndën e matematikës. Kursi fokusohet në bazat e mësimdhënies së matematikës dhe perspektivat e saj. Temat që përmban kursi përfshijnë zhvillimin e kurrikulës së matematikës, të kuptuarit në matematikë, kompetencat matematike dhe konceptet themelore të kurrikulës së matematikës, shqyrtimin e teorive të të nxënit dhe implikimet në mësimdhënie të matematikës. Studentët do të shqyrtojnë probleme të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit të matematikës, dizejnojë aktivitete mësimore për të mbështetur mësimdhënësit gjatë punës me nxënës dhe në veçanti atyre me nevoja të veçanta. Poashtu, studentët do të analizojnë programet bashkëkohore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe do të reflektojnë për përparësitë e tyre.

### **ARSIMIMI GJATË GJITHË JETËS**

Kursi ofron përmbajtje bazike për lëndën e arsimit gjatë gjithë jetës, të arriturat dhe perspektiva e arsimit gjatë gjithë jetës, në vend dhe më gjerë duke vijëzuar periudhat e ndryshme në aspektin kronologjik-shkencor. Në kurs perpunohen përmbajtjeve aktuale të arsimit gjatë gjithë jetës, duke u erqendruar në ecuritë, modalitetet, mjetet si dhe rrethanat favorizuese të kësaj veprimtarie. Poashtu kursi është strukturuar ashtu që të zbardh bazën e motivacioneve, interesave dhe qendrimeve për krijimin e klimës favorizuese për arsimim gjatë gjithë jetës. Kursi do të ofroj përmbajtje teorike dhe aktivitete praktike për tu ndihmuar vijuesve të identifikojnë resurset e shumta që ofron periudha e modernizimit industrial për arsimim gjatë gjithë jetës. Ata do të aftësohen sistematikisht për kërkimin e informacioneve në resurset aktuale për të nxënë gjatë gjithë jetës. Kursi do tu mundësojë vijuesve të zhvillojnë dhe përsosin kulturën për arsimim gjatë gjithë jetës e cila do të jetë në funksion të përcjelljes së risive në fushën e arsimit gjatë gjithë jetës, edhe pas pas kryerjes të këtij niveli të arsimit.

### **PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI NË ARSIM**

Ky kurs përgatitë studentët për procesin e detajuar të organizmit, planifikimit dhe vlerësimit në arsim. Studentët do të jenë në gjendje të përkrahin mësimdhënësit në procesin e planifikimit të mësimit bazuar në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës duke filluar nga planifikimi global, dymujor, javor dhe të një ore mësimorë. Fokus i veçantë do t'i kushtohet përpilimit të rezultateve të të nxënit dhe kritereve të suksesit për njësitë mësimore. Në mënyrë konsistente

ata do të ndërlihdhin metodat e vlerësimit me rezultatet dhe kriteret e suksesit për fusha dhe kompetenca të caktuara. Studentët do të njihen me llojet e vlerësimit në arsim, duke përfshirë vlerësimin e mbrendshëm dhe të jashtëm, vlerësimin kombëtar dhe ndërkombëtar, vlerësimin sumativ dhe formativ etj.

### **PSIKOLOGJI ZHVILLIMORE**

Kursi adreson zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës në fëmijëri dhe proceset e vazhdueshme të funksionimit psikologjik të fëmijës. Kursi shtjellon nocionet e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të fëmijës, dhe ndërveprimet e fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të njohur/kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin fizik, motorik, mendor, emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit, si fëmija i shfaq emocionet, si zhvillohen ato, si socializohet fëmija, si mëson fëmija, dhe si të kujdesemi për fëmijën duke ruajtur mirëqenien psikologjike të tij. Studentët mësojnë për teoritë dhe studimet sistematike të zhvillimit të fëmijës, fazat e zhvillimit nga mosha paranatale deri në adoleshencë, karakteristikat e vecanta të secilës fazë dhe rreziqet që shoqërohen me atë fazë.

### **STATISTIKË**

Ky kurs është dizajnuar që të njihen studentët me konceptet themelore dhe metodat e ndryshme statistikore të cilat aplikohen për hulumtime shkencore pedagogjike. Në kurs studentët do të njihen me vlerat e ndryshme mesatare duke u aftësuar të bëjnë ndarjen e një serie ose shpërndarjen e ranguar në dy pjesë të njëjta, duke vijuar me masat e shpërndarjes të cilat mundësojnë studim të mirëfillt të dukurive pedagogjike. Lënda e statistikës u mundëson studentëve të aftësohen të gjejnë pozitën e rasteve individuale të studimit në grupe. Në hulumtimet pedagogjike përdorim metoda të ndryshme jo parametrike të cilat janë të përfshira në përmbajtjen e kursit në fjalë, ku studentët do të kenë mundësinë fillimisht ti mësojnë dhe aftësohen ti gjejnë ato. Gjithashtu, ata do aftësohen të zbulojnë edhe marrëdhëniet mes dukurive pedagogjike përmes korrelacionit, më pas trajtohen dhe analizat multivariate, anova, krostabulimet dhe duke bërë përmbylljen e lëndës me aftësim të studentëve për përcaktimin e madhësisë së grupeve representative.

### **MENAXHIMI I KLASËS**

Kursi është dizajnuar në mënyrë që studentët të kuptojnë domethënien e menaxhimit të klasës adresimin e udhëzimeve relevante për një funksionim të efektshëm të klasës. Në këtë kurs trajtohen tema që i referohen teorive dhe praktikave të mira për menaxhimin e klasës të ndërlihdhura me veprimet e mësimdhënësit për të organizuar hapsirën, kohën, materialet etj. Të cilat sigurojnë një efektivitet në procesin e të nxënit dhe mësimdhënies. Gjithashtu, në kuadër të këtij kursi trajtohen tema që ndërlihdhen me klasat e stërngarkuara dhe komplekse, vendosjen e rregullave dhe procedurave, ndarjen e përgjegjësi në klasë, nxitjen e bashkëpunimit midis nxënësve, stilet e mësimdhënësit s imenaxhues i klasës dhe menaxhimin e sjelljeve penguese në përgjithësi.

### **ORIENTIMI NË KARRIERË**

Përmes këtij kursi t'u ofrohen studentëve përmbajtje që kanë të bëjnë me rëndësinë që ka informimi dhe orientimi profesional për të rinjët sot, duke i nënkuptuar edhe të rinjët që janë me nevoja të veçanta, për të cilët është i nevojshëm rehabilitimi profesional dhe karriera e

ardhme. Të përvetësojnë gjithashtu të dhëna për përfitimet që u sjell të rinjëve informimi dhe orientimi i drejtë profesional. Nga ky kurs të njihen gjithashtu për mangësitë që mund t'i sjell ,jo vetëm shoqërisë, po edhe individit, dështimi i të rinjëve në profesion e punë, dhe sa mund të ndikoi shkolla ,po edhe faktorët tjerë që ky problem të ngritet në shkallë profesionale dhe institucionale.

### **ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE**

Kursi është përgatitur me synimin që studentët e nivelit master të arrijnë të kuptuarit e proceseve të të mësuarit nga ana e mësimdhënësve duke ndërlidhur këtë me kërkesat ndaj mësimdhënësve për profesionalizim të punës së mësimdhënësit. Kursido ti ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për në shqyrtim mbi modelet e ndryshme të zhvillimit profesional dhe zgjedhjet që mund të bëjnë menaxherët e shkollave dhe sistemeve të arsimit në funksion të zhvillimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si një mjet për përgatitje profesionale të mësuesve. Kursi ofron mundësi për studentët që të kuptojnë kontekstin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në Kosovë dhe aspektet e organizimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional.

### **SHKENCAT NATYRORE DHE KURRIKULA**

Të kuptuarit dhe ndërlidhja e koncepteve themelore dhe njohurive specifike nga natyra e gjallë dhe natyra jo e gjallë është sfiduese në procesin e zbatimit të kurrikulës. Qëllimi i kursit është që të ofroj njohuri pedagogjike dhe shkathtësi praktike për studentët në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e kurrikulës në Fushën kurrikulare Shkencat natyrore. Kursi do të trajtoj konceptet themelore të pedagogjisë së shkencave natyrore, sigurimin e arritjes së kompetencave dhe rezultateve të të nxënit të përcaktuara, planprogrami mësimor dhe zbatimi i tij, metodologjitë e mësimdhënies dhe vlerësimi në shkencat natyrore.

### **EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME**

Kursi ngërthen në analizën e nocionet bazike, karakteristikat e moshës; teoritë pedagogjike të avancuara për edukimin e fëmijëve në moshë të hershme; politikat arsimore vendore dhe ndërkombëtare për këtë hallkë të sitemit të arsimit; parimet, qëllimet dhe faktorët primarë të edukimit në fëmijërinë e hershme; strategjitë e edukimit parashkollor dhe reflektimi kritik për to; Studentët gjatë këtij kursi do të hospitojnë së paku dhjetë aktivitete edukative në klasat parafillore ose në kopshte duke reflektuar mbi rrjedhën e tyre dhe duke dhënë rekomandimet e tyre.

### **ARSIMIMI I TË RRIURVE**

Kursi ofrohet për të promovuar bazat teorike të veprimtarisë arsimore me të rritur dhe për të reflektuar të kuptuarit dhe nocionet bazë të cilat e karakterizojnë arsimin e të rriturve në teori dhe në praktike. Në kurs trajtohen nevojat sociale të njeriut të rritur, motivimi, interesat e qëndrimet për arsimim të vazhdueshëm. Në kurs gjithashtu trajtohen dinamikat e punës me grupe shikuar nga aspekti i ndërtimit të mekanizmave që e karakterizojnë punën dhe raportet e punës arsimore me të rritur. Kursi ofron diskutime për problemet aktuale dhe perspektivën e arsimit të të rriturve në shoqërinë bashkëkohore. Pas perfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë të pajisur me një kornizë që i ndihmon ata të zhvillojnë kulturën e arsimit të vazhdueshëm, të reflektojnë për rëndësinë e përgatitjes dhe të aftësisimit të të rriturve, të debatojnë rreth nocioneve: arsim i të rriturve, arsim i vazhdueshëm, dhe arsim gjatë gjithë

jetës, dhe të jenë në gjendje të identifikojnë, vlerësojnë, dhe zbatojnë metodat më të përshtatshme për mësimnxënie të vazhdueshme.

### **PRAKTIKUM I PUNËS SË PEDAGOGUT**

Kursi ofron mundësi për zhvillimin e shkëlqësive të studentëve për punën e pedagogut të shkollës lidhur me: planifikimin, programin dhe organizimin e punës arsimore, realizimin e efektshëm të procesit arsimor, përcjelljen, hulumtimin, analizën dhe vlerësimin e punës së shkollës, bashkëpunimin me faktorët në shkollë (nxënës, prindër, mësimdhënës, institucione, menaxhuese dhe profesionale), zhvillimin profesional të mësimdhënësve, përkujdesjen për dokumentacionin pedagogjik shkollor. Përmes këtij kursi, studentët aftësohen për të qenë në gjendje të ofrojnë udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit, prindërit me qëllim të mbarëvajtjes së sukseshme të procesit arsimor përmes mbështetjeve të aktiviteteve në shkollë, punëtorive, trajnimeve profesionale, vlerësimin e efekteve të trajnimeve dhe formave të tjera të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me qëllim të rritjes së rezultateve të nxënësve.

### **PSIKOLOGJI E EDUKIMIT**

Psikologjia e Edukimit është e konceptuar si vazhdim i përmbajtjeve të mësuara në lëndën e Hyrjes në Psikologji. Kursi ofron njohuri për të nxënë dhe punën psiko-edukative me fëmijët. Kursi do të trajtojë çështje mbi edukimin e fëmijëve që nga lindja deri në moshën shkollore, zbatimin e psikologjisë në studimin të nxënës, punës direkte me fëmijët, motivimit dhe çështjeve tjera, që ndërlidhen me procesin e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike në punën direkte me fëmijët, dhe i mundëson studentëve të ndërtojnë dhe rindërtojnë teorinë personale të të mësuarit përgjatë këtij kursi. Theks i veçantë do të vendoset tek të nxënës, motivimi, kreativiteti në klasë, dhe ndikimet që ka mjedisi tek sjellja e fëmijës.

### **ETIKA NË MËSIMDHËNIE**

Kursi trajton aspektin etik të mësimdhënësit dhe ndikimit të tij në student, qoftë me fjalën e me veprimin e tij, qoftë me zbatimin e tij në mësimdhënie. Në kurs do të trajtohen edhe aspektet e tjera duke filluar nga kodet etike, kodi i mirësjelljes, etj. për përcaktimin e vlerave dhe sjelljeve të pëlqyeshme dhe duke u përqendruar në terminologjinë e etikës profesionale të mësimdhënësve, si në kontekstin kronologjik ashtu edhe në kontekstin bashkëkohor. Në kurs definohet nocioni i vlerës, parimeve etike si dhe do të studiohet gjeneza e vlerave etike. Poashtu, do të ofron njohuri teorike dhe shkathtësi praktike për zbatimin e etikës në mësimdhënie por edhe në përditshmëri.

### **BAZAT TEKNOLOGJIKE TË PUNËS MËSIMORE**

Ky kurs ofron informacionet bazike për teknologjitë e edukimit dhe zbatimin e tyre në praktikën mësimore. Në kurs trajtohen mënyrat dhe format duke filluar nga ato më elementare e deri tek ato më të avancuara të përdorimit të teknologjive të edukimit në procesin mësimorë. Poashtu do të trajtohet edhe zbatimi i teknologjive të edukimit në punën hulumtuese e shkencore. Në kurs do të përpunohen shumë përmbajtje aktuale që sjellë zhvillimi në sferën e teknologjive të reja të edukimit në kushtet e zhvillimit të vazhdueshëm në shoqërinë bashkëkohore.

### **ARTET DHE KURRIKULA**

Kursi është i dizajnuar që t'i ofroj studentëve shkathtësi pedagogjike dhe praktike në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e kurrikulës në fushën kurrikulare ARTET (muzikë, vallëzim, dramë dhe arte pamore). Meqë artet e ndryshme kanë specifikat e tyre, do të realizohen koncepte e përbashkëta dhe dallimet në mes tyre në kuadër të fushës Artet, që janë të shtrira në gjitha nivelet e sistemin arsimor. Kursi përgatitë studentët të promovojnë aspektin kreativ të mësimdhënies së integruar dhe asaj të diferencuar të fushës së arteve si: edukatë muzikore, vallëzim, dramë dhe artet pamore, si veprimtari e rëndësishme kurrikulare në të gjitha nivelet e edukimit.

### **PEDAGOGJI SPECIALE**

Kursi ofron njohuri bazike në fushën e pedagogjisë speciale, personat me nevoja të veçanta, dëmtimet e natyrave të ndryshme dhe mundësinë e integritit të personave në procesin e edukimit. Gjithashtu, trajtohen tema që promovojnë filozofinë e arsimit inkluziv. Përmes këtij kursi, studentët do të kenë mundësi të njihen me dëmtimet e llojeve të ndryshme: dëmtimet në të parë, në të dëgjuar, vështirësitë në komunikim, prapambetjen mendore etj. Kursi ofron edhe analizë të hollësishme të strategjive të mësimdhënies për punë me nxënës me nevoja të veçanta, forma e aktivitete të ndryshme, të cilat promovojnë vlerat e arsimit gjithëpërfshirës.

### **METODIKË ME PUNË PRAKTIKE**

Kjo lëndë do t'ju japë mundësi studentëve për zbatimin e ideve didaktiko-metodike dhe njohurive të tyre teorike për nxënien dhe mësimdhënien në mjediset reale shkollore. Ajo ofron qasje fundamentale metodike për asistimin e mësimdhënësve në procesin e dizajnit, strukturimit, planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve mësimore për të gjithë nxënësit. Shumë mësimdhënës të shkollave në Kosovë punojnë me klasa të mbingarkuara dhe në mjedise pa përkrahje. Ata kanë nevojë për ndihmë praktike në dizajnimin e aktiviteteve për nxënësit e tyre, duke marrë për bazë rezultatet e synuara, grupin e nxënësve dhe mjedisin mësimor. Për më tepër, përvojat praktike do t'i bëjnë studentët të kuptojnë se asnjë qasje, përkatësisht metodë nuk funksionon njejtë për secilin nxënës.

### **PRAKTIKË NË IA**

Ky kurs ka për qëllim praktikimin e njohurive dhe shkathtësive të përfituara nga kurset e tjera në ambient real në ndonjë institucion arsimor. Studentët do të qëndrojnë në Insituacione arsimore për katër javë rradhazi, çdo ditë pune në orar të plotë ndërsa një herë në javë do të takohen në fakultet për të shkëmbyer përvojat dhe për të reflektuar praktikën që kanë vëzhguar ose zbatuar. Vëzhgimi dhe pjesëmarrja aktive e studentëve në jetën shkollore është e domosdoshme për të zhvilluar shkathtësitë në një ambient autentik. Studentët do të përdorin ditarin reflektiv personal duke dokumentuar çdo ditë të praktikës në IA. Studentët do të analizojnë dokumentacionin pedagogjik, planet mësimore të përgatitura nga mësimdhënësit, do të japin komente mbi ato plane dhe të gjitha do t'i ruajnë në portfolio. Do të mbajnë takime me nxënësit duke synuar njohjen e nevojave, vështirësive, interesave që mund të kenë. Gjithashtu, ata mund të mbajnë edhe takime individuale me nxënës dhe prindër me qëllim të këshillimit për përkrahjen e nxënësve në të nxënë. Studentët duhet të marrin pjesë në çdo aktivitet që organizohet në shkollë, mledhje të prindërve, aktivitete kulturore apo me aktivitete të zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

## **SISTEMI I ARSIMIT NË KOSOVË**

Kursi ofron mundësi për studentët të njihen me ciklin e zhvillimit të politikave arsimore si dhe me politikat aktuale në fuqi si dokumente kurrikulare, strategjitë dhe politikat e ndryshme të standardeve të mësimdhënies si licencimit i mësimdhënësve, orientimet e kurrikulës shkollore, standardet e performancës së drejtorëve të shkollave etj. Kursi gjithashtu ofron mundësi për studentët të njihen me dokumentet kryesore legjislative në sistemin e arsimit në Kosovë si ligjet e arsimit dhe udhëzimet e ndryshme administrative që rregullojnë aspekte të ndryshme të funksionimit të sistemit arsimor në Kosovë.

## **EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETËSOR**

Kursi ofron informacione në lidhje me zhvillimin fizik dhe lëvizor në fëmijërinë e hershme, që janë mjaft të rëndësishme dhe kanë lidhje të ngushtë me të gjitha fushat e tjera të zhvillimit. Kursi ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit të shëndetit dhe atij motorik, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete, të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë.

## **MENAXHIMI I PROJEKTEVE**

Kursi ka për fokus që studentët të njihen me teorinë dhe praktikën e hartimit dhe zhvillimit të projekteve. Kursi do të ndihmojë studentët të kuptojnë logjikën e të kuptuarit të sistemit arsimor në Kosovë dhe identifikimin e qështjeve që mund të shëndërrohen në projekte zhvillimore në shkollë. Edhe pse kursi zbaton logjikën e projekteve të përgjithshme, kjo do të orientohet drejt projekteve zhvillimore në shkollë. Studentët do të kalojnë nëpër hapat dhe procedurat e zhvillimit të një projekti dhe do të kuptojnë edhe aspektet e tjera përcjellëse si monitorimi dhe vlerësimi i projekteve.

## **SHKATHTËSITË PËR JETË DHE PUNË**

Kursi ka për synim të ofroj fëmijut hapësirë të gjithëmbërshme për zhvillimin e shkathtësive të ndryshme për jetë dhe punë. Kursi shkathtësitë për jetë dhe punë shtjellon zhvillimet e gjithëmbërshme të fëmijut, ndërveprimet e tij me individët tjerë, ndërveprimet me mjedisin ku ai jeton si dhe ndikimet e tilla në zhvillimin e tij. Në këtë kurs studentët njihen me mjedisin jetësor dhe me materialet e ndryshme që na rrethojnë në natyrë, përdorimin e materialeve me fëmijë për krijimin e figurave apo objekteve të ndryshme me punë individuale apo grupe si dhe nxitjen e dëshirës për punë kreative nga materialet e ndryshme nëpër qerdhe apo në institucione parashkollore. Përmes projekteve grupe dhe individuale ushtrohet zbatimi i materialeve si: letra, argjili, gipsi, sapuni, plastelina, qiri, produktet ushqimore, etj. Projektet ndijmojnë fëmijët, stimulojnë dhe rrisin nxitjen e dëshirës për punë kreative të shkathtësive të tyre për punë në jetë.

## **PROVIM DIPLOME (PORTFOLIO)**

Punohet në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor.